



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3519 / Prot. 4

Patos më 02 .12.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 27.11.2025

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisininaj
3. Liljana Mesutaj
4. Lori Musaj
5. Artan Velçani
6. Armand Ahmetaj
7. Ertilla Myrtaj
8. Elton Seraj
9. Suela Hoxha
10. Smerald Hazizaj
11. Renaldo Shpata
12. Vjollca Kasaj
13. Novrus Toska
14. Gani Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Jemi në mbledhjen e këshillit bashkiak e cila bazohet në nenin 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Pjesëmarrja në mbledhje është 14 këshilltarë.

Armand Ahmetaj- Para se të lexoj rendin e ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr ndonjë pikë meqënëse materialin e keni marrë konform rregullave?

Çajup për ty është pyetja.

Çajup Refitaj- Lidhur me projektvendimin e propozuar nga ana jonë mbi strukturën për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 në kushtet që kemi parë të arsyeshme dhe të nevojshme për të rishikuar disa elementë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me paketën kërkojmë të tërhiqemi nga kjo seanca e sotme për të shtytur për seancën e radhës deri në rishikimin e këtyre elementeve që thamë si pjesë përbërse të paketës fiskale.

Faleminderit !

Armand Ahmetaj- Besoj të gjithë jemi dakord për këtë pjesë!

Armand Ahmetaj- Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.10.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.10.2025.

4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin tetor 2025".

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin tetor 2025".

6- Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale".

7- Projekt-vendim "Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026".

8- Projekt-vendim "Për miratimin e planit vjetor të punës, të aktiviteteve dhe të konsultimeve publike të këshillit bashkiak Patos për vitin 2026".

Armand Ahmetaj- kush është dakord me miratimin e rendit e ditës?

Miratohet me 14 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerol Haxhiu

Gjilja Myrtaj

Penshda Shkoto

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3544 / 5 Prot.

Patos më 02.12.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.10.2025

Armand Ahmetaj –Keni propozim për korrigjimin e procesverbalit? Keni ndonjë paqartësi? Nëse nuk keni konsiderohet i miratuar në bazë të rregullores.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerold Hoxhaj
Eshler Murtezi
Penselbo Shpete

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3514 / Prot.
6

Patos më, 02 12.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 ora 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.10.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 30.10.2025 u morën gjithsej 7 vendime nga nr. 67 deri në 73.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 69 i është përcjell Prefekturës për verifikimj dhe ka ardhur përgjigja se vendimi është në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerod Hoxhaja
Egëlo Myrtaj
Benedto Shpata

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3484 / Prot.
13

Patos më 02 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin tetor 2025".

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 72 datë 17.11.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin tetor 2025".

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin tetor 2025 gjithsej 16 familje me një vlerë totale prej 67,163 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

Me listën jeni njohur nëpërmjet emailit.

Lori Musaj - Kryetare e komisionit të ekonomisë- Përhëndetje të gjithëve! Komisioni ekonomisë u mbledh ditën e martë dhe ka diskutuar mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazë ligjore dhe e kemi miratuar pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota pro. Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin tetor 2025".

Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerdet Hoxhi
Eshita Myrtaj
Remele Shpate

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 34831 Prot.
13

Patos më 02 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin tetor 2025".

Mitjon Nikolla – Proektvendimi nr. 71 datë 17.11.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin tetor 2025".

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin tetor 2025 gjithsej 17 familje me një vlerë prej 64,346 (gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzetë e gjashtë) lekë.

Lori Musaj - Kryetare e komisionit të ekonomisë- Në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili është konstatuar në përputhje me ligjin dhe e kemi miratuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë propozim?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin tetor 2025".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smereta Kozari
Gjilina Myrtaj
Rendeta Shkoto

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3368/3 Prot.

Patos më 02 .12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale".

Mimoza Shtëmbari - në bazë të VKM numër 483 kemi paraqitur projektvendimin për miratim për buxhetin shtesë për vitin 2025 në transfertën sektoriale.

Vendimi Këshillit të Ministrave është marrë për dhënien shpërblim të personelit të angazhuar për shuarjen e zjarreveve gjatë 2025, ku me aktin normative nr. 10 datë 08.10.2025 është alokuar fondi prej 1 milion 302 mijë për dhënie shpërblim një page të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi të cilët kanë qenë të angazhuar në shuarjen e zjarreve. Shoqëruar është dhe relacioni i projektvendimit. Kërkoj të miratohet buxheti shtesë për dhënien shpërblim të punonjësve të mbrojtjes nga zjarri.

Lori Musaj- Gjatë mbledhjes së komisionit kemi diskutuar me ekzekutivin dhe mbi këtë projektvendim i cili është në përputhje me ligjin dhe ne kemi vendosur ta miratojmë me tre vota pro por duhet të them se ky shpërblim është e merituar dhe i domosdoshëm për të motivuar dhe mbështetur këta trupë punonjësish të cilin përballen me situata të jashtëzakonshme.

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord ?
Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerod Hoxhi
Gjilber Myrtaj
Renelbe Shkote

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 34791 / 3 Prot.

Patos më 02 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi

Juela Shpata – sot paraqesim përpara jush projektvendimin numër 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026", pikë së pari theksoi se niveli pagave nuk ka asnjë ndryshim nga ky nivel që kemi patur gjatë gjithë vitit 2025

Gjithashtu gjatë komisionit të ekonomisë ditën e martë nga ana e këshilltarit Eduart Faslliaj në tabelën numër 8 është verejtur një lapsus në ana ime që është pikërisht në pikën 2 kopshti pa drekë nga është lëvizur padashje tabela dhe paga e drejtorit të kopshtit është 75.

Projektvendimi që po ju paraqesin për miratim bazohet në Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe është i domosdoshëm për të mbushur detyrimin ligjor të parashikuar në shkronjën ç të nenit 54 të ligjit 139/2015 Për Vetqeverisjen Vendore i ndryshuar ku shprehet se këshilli i bashkisë miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Sipas të dhënave të gjendjes civile numri i regjistrit të gjendjes civile për vitin 2025 për bashkinë Patos është 42 mijë e 120 banorë.

Bashkia Patos grupohet në kategorinë e njësisve të vetëqeverisjes vendore deri në 50 mijë banorë kur numri i banorëve përcakton klasat kategorinë dhe nivelin e pagave për çdo pozicion pune në lidhje me nivelin e pagave për nëpunësit civilë dhe në punonjësit që janë me kodë pune i jemi referuar lidhjes numër 8 të vkm 503 datë 1.08.2024, gjithashtu të gjithë punonjësit përfitojnë shtesën për vjetërsi sipas vkm-ve përkatëse dhe punonjesit administrative.

Gjithashtu punonjesit IT përfitojnë një shtesë prej 5 mijë lekë të reja në muaj.

Përsa më sipër ftojme këshillin e bashkisë që të miratoj nivelin e pagave pa ndryshime.

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit u diskutua dhe kjo pikë e cili konstatohet se është në përputhje me bazën ligjore dhe ne kemi vendosur të votojmë me 2 vota pro dhe 1 kunder

Albiona Lamaj- për ta kuptuar më qartë këshilli i bashkisë ka të drejtë të vendosi që ky nivel pagave është sipas vkm domethënë zbaton ligjin e pagës minimale dhe pagës maksimale për secilin punonjës

Juela Shpata – Paga minimale është e miratuar ne nuk ndërhyjmë dot

Albiona Lamaj - po pra dhe neve marrim këtë projektvendim e votojmë për këtë gjë për të parë nëse është zbatuar ligjshmëria për secilin punonjës të bashkisë tani propozimi im do të jetë ky që ne ta miratojmë këtë projektvendim me kushtin që në zbardhjen e projektvendimit të mos jetë e përcaktuar niveli pagave për secilin pra ajo shumë totale që përcakton që është brenda ligjit ose jo.

Juela Shpata – Edhe njëherë të lutem,

Albiona Lamaj Ne si këshill marim vendimin për të parë që niveli pagave për secilin punonjësit është në përputhje me ligjin ose jo.

Kryetari Bashkisë- Jo ne si këshill por ju si anëtare e keshillit

Albiona Lamaj Po unë si anëtare keshilli dhe në këtë moment që unë marr shikoj që është në përputhshmëri me ligjin ose jo në këtë projektvendim shikoj shumën totale të pagës që i përgjigjet ligjit ose jo dhe në momentin që kjo i përgjigjet ligjit nuk kam pse të miratojë pagën për secilin punonjes.

Juela Shpata- Ja të ta shpjegoj unë, në të gjitha tabelat nëse do ta keni parë me vëmendje kalojmë tek tabela 1 dhe 2 që i kam për kollaj të tregoj se tabela numër 1 është niveli i pagës për funksionarët në bashkinë Patos ka një minimum ka një maksimum sipas Vkm 503.

Tabela nr. 3 është për punonjësit e administratës që trajtohen me kod pune që ne për mos ti dhënë më pak si punonjës administrativ që trajtohen me vkm e tjera ne i kemi përfshirë këtu për mos të krijuar dispalanca midis punonjësve.

Tabela numër katër është niveli i punonjësve administrativë bashkisë Patos, kjo do të ndryshoi besoj në janar në vitin që vjen me ndryshimin e pagës minimale.

në tabelën numër 5 dhe 6, janë ndërmarrjet vetëse.

Në tabelën numër 7 janë punonjësit e bordit të kullimit ata janë të miratuar me Vkm nuk ndryshojmë dot gjë ne as nuk ndërhyjmë dot.

Në tabelën numër 8 arsimit parashkollor dhe arsimit parauniversitar nuk ndërhyjmë dot dhe në tabelën 9 Qendra multifunkionale që ne jemi futur përpara dy muajsh me ndryshim për të gjitha punonjëset dhe tabela numër 10 është sektori mzsh që ne përsëri nuk ndërhyjmë dot se janë nga transfertat specifike.

Juela Shpata – Duke qënë se ju e keni parë projektvendimin me vëmendje të thotë që në përputhje me ligjin ky është shumë i plotë për faktin e vetëm se keni pagë pozicioni keni të shtesën për secilin punonjës.

Albiona Lamaj - tani përcaktimi midis pagës minimale dhe maksimale është kompetencë e bashkisë duke vlerësuar gjithë pjesët tani në momentin që kjo është kompetecë e Bashkisë të mos kalojë kjo pjesë e tabelës në projektvendim për të miratuar nga këshilli ne na lini pagën minimale dhe maksimale dhe shumën totale nuk kemi pse ne të miratojmë në projektvendim pagën për secilin nga punonjësit.

Kryetari Bashkisë- Është pagë pozicioni kategori punonjësi nuk është pagë me emër punonjësi nëse do ishte pagë me emer punonjësi ndryshon gjëja.

Albiona Lamaj- Në momentin që ne nuk e kemi këtë kompetencë në projekt vendim ne marim vendimmarrje vetëm për nëse është zbatuar apo jo ligjshmëria dhe ne na intereson shuma në fund e pagave për secilin nga këta me shumën totale që do dalin nga paga minimale dhe maksimale.

Juela Shpata- ne paraqesim në këshill vetëm miratimin e secilës kategori pastaj se çfarë kategorie kategorizon kryetari secilin pozicion në strukturë është kompetencë e tij.

Klaudio Alisinanaj – Të lutem që të qartësohemi, ne nuk po miratojmë nivelin e pagave të çdo punonjësi.

Juela Shpata –jo

Albiona Lamaj- Kategoritë.

Klaudio Alisinanaj- ok shumë e qartë.

Armand Ahmetaj – Nëse nuk kemi pyetje të tjera propozoj të kalojmë në votim

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska


SEKRETARE

Refaela Xeba



Smeralda Hoxha
Ebiler Mykaj
Pernelto Shpata

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 34771 Prot.
13

Patos më 02 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 27.11.2025 në orën 14:18, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e planit vjetor të punës, të aktiviteteve dhe të konsultimeve publike të këshillit bashkiak Patos për vitin 2026”.

Armand Ahmetaj - ky është një plan i gjithë njohur ne kemi detyrim ligjor ta miratojmë çdo vit materialin e keni patur kështu që nuk besoj se kemi pyetje është plani punës i vetë këshillit kemi ndonjë diskutim pyetje?

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën tetë Projekt-vendim “Për miratimin e planit vjetor të punës, të aktiviteteve dhe të konsultimeve publike të këshillit bashkiak Patos për vitin 2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerolë Hoxha
Eshler Myrtaj
Renaldo Shpota

KRYETAR
Armand Ahmetaj